



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 30 shtator 2024

Njoftim për shtyp

Rishikimi i të dhënave në statistikën e jashtme për periudhën 2022 – 2023

Në pajtim me standardet e përshkruara ndërkombëtare dhe politikën për rishikim të të dhënave për statistikën e jashtme të publikuara në kuadër të Sqarimeve metodologjike, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut zbaton rishikimin e të dhënave të publikuara për statistikën e jashtme (bilancin pagesor, borxhin/kërkesën e jashtme bruto dhe pozitën e investimeve ndërkombëtare, si dhe zhvillimet të investimet direkte) në bazë të rregullt vjetore.

Rishikimi kryesisht vjen nga nevoja për kyçjen e të dhënave të reja nga burimet e të dhënave të cilat mbledhen me dinamikë vjetore, ndërsa me qëllim që të përmirësohet fushëveprimi dhe klasifikimi, domethënë të cilësisë së të dhënave të shfaqura.

Më konkretisht, rishikimi i të dhënave në pjesë më të madhe vjen nga:

- *Përfshirja e të dhënave nga pyetësorët vjetor për investimet në/nga jashtë për vitin 2023.*
- *Rishikimi i të dhënave për import dhe eksport të mallrave për vitin 2022, si rezultat i marrjes së të dhënave definitive për shkëmbimin e jashtëm tregtar të mallrave për vitin 2022.*
- *Kryqëzimi i kontrollimit të cilësisë nga burimet e përdorura, që sjell ndryshime në shtrirjen e të dhënave dhe/ose riklasifikime shkaku i shtrirjes dhe cilësisë më të mirë të të dhënave për vitin 2023.*

Bilanci i pagesave

Suficiti i llogarisë rrjedhëse për vitin 2023 është 55,6 milionë euro, respektivisht pas rishikimit të realizuar tregon ulje prej 39,7 milionë euro. I shprehur përmes treguesve relativë, suficiti i llogarisë rrjedhëse në raport me PBB-në për vitin 2023 pas rishikimit u ul nga 0,7% në 0,4% (rënie prej 0,3 p.p.).

Komponenti më i rëndësishëm që vepron mbi rishikimin e llogarisë rrjedhëse është **nënbilanci i mallrave**, në kahje të rritjes së deficitit në këmbimin e mallrave për 57,8 milionë euro, si rezultat i klasifikimit më të mirë të të dhënave.

Rishikimi i të dhënave të **nënbilancet e shërbimeve** është në drejtim të rritjes së suficitit për 1,8 milionë euro, si rezultat i përfshirjes më të mirë dhe riklasifikimit të të dhënave.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Deficiti në nënbalancin e **të hyrave primare** është ulur për 6,2 milionë euro. Rishikimi është rezultat i ndryshimit të shumave të vlerësuara të fitimit të sapokrijuar me rezultatin financiar të realizuar, të cilat tregojnë dalje neto më të ulëta për 8,7 milionë euro. Gjegjësisht, fitimi i sapokrijuar është relativisht më i ulët në krahasim me vlerësimin për vitin 2023, ndikoi në uljen e daljeve të investimeve direkte në vend për 19,6 milionë euro, ndërsa rishikimi i investimeve direkte jashtë vendit është në drejtim të kundërt dhe tregon rënie të hyrjeve për 10,9 milionë euro (vlerësim më i lartë për sa i përket arritjeve).

Efektet nga rishikimi mbi bilancin e pagesave në vitin 2022 dhe 2023.

(në milionë euro, në %)

	para rishikimit		pas rishikimit		Dallimet	Dallimet
	2022	2023	2022	2023	2022	2023
I. Llogaritë rrjedhëse	-797.4	95.3	-801.3	55.6	-3.9	-39.7
Mallra	-3,481.0	-2,576.3	-3,481.6	-2,634.1	-0.6	-57.8
Shërbime	751.9	733.7	748.5	735.5	-3.4	1.8
Hyrje primare	-568.4	-748.6	-568.4	-742.4	0.0	6.2
Hyrje sekondare	2,500.2	2,686.6	2,500.2	2,696.6	0.0	10.1
II. Llogaria kapitale, neto	0.0	-1.6	0.0	-0.9	0.0	0.6
III. Llogaria financiare, neto	-756.1	154.5	-760.1	95.9	-4.0	-58.7
Investimet direkte, neto	-654.2	-523.1	-654.2	-488.1	0.0	35.0
Investime të portofolit, neto	-52.1	33.8	-52.1	34.0	0.0	0.2
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opcionet e të punësuarve për blerje të aksioneve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investimet e tjera, neto	-321.3	37.7	-325.3	-53.2	-4.0	-90.8
Kapitali i mbetur vetanak	-3.2	-0.7	-3.2	-0.7	0.0	0.0
Valuta dhe depozita	383.0	413.2	382.9	412.7	-0.1	-0.5
Huamarrje	-372.7	-403.2	-372.7	-403.5	0.0	-0.3
Sigurime, pensione dhe skema të garancioneve të standarizuara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanse	-321.7	23.8	-325.6	-66.2	-3.9	-90.0
Llogari të tjera për pagesë	-5.7	5.2	-5.7	5.2	0.0	0.0
Të drejtat special të tërheqjes (Krijimi i detyrimit, neto)	1.0	0.7	1.0	0.7	0.0	0.0
Rezervat devizore oficiale	271.6	606.1	271.6	603.1	0.0	-3.0
Gabimet dhe lëshimet, neto	41.3	60.8	41.2	41.1	-0.1	-19.6

Zëra memorandumi

Investime direkte të jashtme	90.8	93.6	90.8	89.7	0.0	-4.0
Investime direkte në vend	745.0	616.7	745.0	577.7	0.0	-39.0
Llogaritë rrjedhëse, % në PBB	-6.1	0.7	-6.1	0.4	0.0 p.p.	-0.3 p.p.
Balansi tregtar (f.o.b.) % në PBB	-26.7	-18.9	-26.7	-19.3	0.0 p.p.	-0.4 p.p.
ID në vend % në PBB	5.7	4.5	5.7	4.2	0.0 p.p.	-0.3 p.p.

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) shënon hyrjet neto nga jasht. Te rezervat valutove shenja (+) shënon rritje, ndërsa shenja (-) shënon uljen e mjeteve valutove.

Burimi: BPRMV-ja, EshS-ja.

Suficiti të **nënbilanci i të hyrave sekondare** është rritur për 10,1 milionë euro, kryesisht si rezultat i përfshirjes së të dhënave për tatimin e arkëtuar/paguar nga investitorët gjatë transferimit të fitimit, të fituar nga pyetësori për investime në/nga jashtë (rritje e të hyrave neto me 8,6 milionë euro). Ndryshimet në pjesën tjetër të komponentëve funksionuan në të njëjtin drejtim dhe janë rezultat i mbulimit më të mirë të të dhënave nga burimi i qarkullimit pagesor.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Rishikimi i **llogarisë kapitale** rezulton me uljen e deficitit për 0,6 milionë euro, kryesisht shkaku i shtrirjes më të mirë të të dhënave në burimet.

Daljet neto në **llogarinë financiare**, pas rishikimit të kryer, u ulën për 58,7 milionë euro, në pjesë më të madhe si rezultat i rritjes së detyrimeve neto në bazë të kredive tregtare (për 90 milionë euro), ndërsa detyrimet neto në bazë të investimeve direkte janë ulur për 35 milionë euro.

Si rezultat i përfshirjes së të dhënave nga pyetësi vjetor të cilat zëvendësojnë shumatat e vlerësuara të fitimit të sapokrijuar dhe dividendët e llogaritur, si dhe kryqëzimet e cilësisë së të dhënave, detyrimet neto bazuar në **investimet direkte** janë ulur për 56,7 milionë euro, ndërsa mjetet neto janë ulur për 21,7 milionë euro. Detyrimet neto të ulura në bazë të investimeve direkte janë rezultat i uljeve të vërejtura në të tre kategoritë: riinvestimi i fitimit (për 33,5 milionë euro), borxhi ndërkompani (për 20 milionë euro) dhe kapitali vetanak (për 3,1 milionë euro). Rënia e mjeteve neto bazuar në investimet direkte është si rezultat i uljes së kërkesave ndërkompani (për 12,1 milionë euro) dhe të riinvestimi i fitimit (për 10,5 milionë euro), gjatë rritjes së kapitalit vetanak (për 0,9 milionë euro).

Analizuar sipas drejtimit të investimeve, **investimet direkte në vend**, pas rishikimit, shënojnë ulje për 39 milionë euro, ku pjesëmarrja e tyre në PBB-në u ul për 0,3 p.p. dhe paraqet 4,2% e PBB-së.

Në kuadër të investimeve tjera, rishikim më të rëndësishëm shënojnë **kreditë tregtare** me rritje të detyrimeve neto për 90 milionë euro, si rezultat i klasifikimit më të mirë të të dhënave nga qarkullimi i pagesave (kryesisht rishpërndarje nga aktivitetet e ndërmjetësimit të mallrave në detyrimet neto bazuar në importet e rregullta të mallrave), si dhe rishpërndarje më të mirë të kredive tregtare afatshkurtra ndërmjet subjekteve të lidhura dhe jo të lidhura. Detyrimet neto në bazë të **kredive** nuk shënojnë ndryshim të rëndësishëm (rritje për 0,3 milionë euro).

Pas rishikimit, **gabimet dhe lëshimet në bilancin e pagesave janë ulur për 19,6 milionë euro** dhe janë 41,1 milionë euro (me parashenjë pozitive).

*Deficiti i **llogarisë rrjedhëse** për vitin 2022 është 801,3 milionë euro, respektivisht shënoi rritje prej 3,9 milionë euro, ndërkohë që treguesi i bilancit të llogarisë rrjedhëse në raport me PBB-në mbetet i pandryshuar.*

Arsyeja kryesore për rishikimin e vitit 2022 është përfshirja e të dhënave përfundimtare për tregtinë e jashtme për vitin 2022 të marra nga Drejtoria e Doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo ka ndikuar në drejtim të rritjes së detyrimeve në bazë të kredive tregtare për 3,9 milionë euro.

Gabimet dhe lëshimet në bilancin e pagesave janë ulur për 0,1 milionë euro dhe shënojnë 41,2 milionë euro (me parashenjë pozitive).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Borxhi i jashtëm bruto, kërkesa të jashtme bruto dhe borxhi i jashtëm neto

Me rishikimin vjetor të të dhënave, gjendja e borxhit të jashtëm bruto dhe e kërkesave të jashtme bruto janë ulur (për 106,6 milionë euro, respektivisht 14,7 milionë euro), gjë që çoi në uljen e borxhit të jashtëm neto për 91,9 milionë euro. Treguesi relativ, borxhi i jashtëm bruto i shprehur në përqindje ndaj PBB-së, për vitin 2023, pas auditimit është 83,2%, që paraqet ulje për 0,8 p.p., ndërsa kërkesat e jashtme bruto arrijnë në 51,2% të PBB-së, që paraqet rënie prej 0,1 p. p..

Në anën e borxhit të jashtëm bruto, analizuar sipas sektorëve, rishikimi ka ndikimin më të madh në uljen e borxhit ndërkompani (për 96,1 milionë euro), pastaj detyrimet e sektorëve të tjerë (për 9,9 milionë euro), si dhe në sektorin shtetëror (për 0,6 milionë euro).

Efektet nga auditimit mbi borxhin, kërkesa dhe borxhi neto në vitin 2023
(në milionë euro, në %)

Sektori i rezidentëve	Borxhi i jashtëm bruto			Kërkesat e jashtme bruto			Borxhi i jashtëm neto		
	Para rishikimit	Pas rishikimit	Dallimi	Para rishikimit	Pas rishikimit	Dallimi	Para rishikimit	Pas rishikimit	Dallimi
1. SHTETI	3,785.1	3,784.5	-0.6	0.0	0.0	0.0	3,785.1	3,784.5	-0.6
2. BANKA QENDRORE	609.8	609.8	0.0	4,125.0	4,125.0	0.0	-3,515.2	-3,515.2	0.0
3. INSTITUCIONET DEPOZITARE, përveç bankës qendrore	976.2	976.2	0.0	785.2	785.2	0.0	191.0	191.0	0.0
4. SEKTORËT E TJERË	2,970.5	2,960.6	-9.9	1,243.9	1,243.5	-0.4	1,726.6	1,717.1	-9.5
5. INVESTIMET DIREKTE: Kredi ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura	3,121.1	3,025.0	-96.1	850.1	835.8	-14.3	2,271.0	2,189.2	-81.8
BORXHI I JASHTËM BRUTO	11,462.7	11,356.1	-106.6	7,004.2	6,989.5	-14.7	4,458.5	4,366.6	-91.9
BORXHI I JASHTËM BRUTO % PREJ PBB	83.9	83.2	-0.8	51.3	51.2	-0.1	32.6	32.0	-0.7

Burimi: BPRMV-ja, EshS-ja.

Në anën e kërkesave të jashtme bruto, ndryshimi në tërësinë e tij rezulton nga rënia e kërkesave ndërkompani (për 14,3 milionë euro) dhe kërkesat e sektorëve të tjerë (për 0,4 milionë euro).

Pas kryerjes së auditimit, borxhi i jashtëm neto për vitin 2023 është ulur për 91,9 milionë euro, para se gjithash si rezultat i uljes së borxhit ndërkompani për 81,8 milionë euro dhe në sektorët e tjerë për 9,5 milionë euro.

Pozita e investimeve ndërkombëtare

Auditimi i të dhënave në raportin për PIN-in, përveç ndryshimeve të instrumenteve të borxhit, e përfshirë në raportet për borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesave të jashtme bruto, përfshijnë ndryshime edhe të instrumentet vetanake, kryesisht në kuadër të zërave të investimeve direkte dhe të portofolit. Auditimi të instrumentet vetanake vjen nga nevoja për shkëmbimin e të dhënave të vlerësuara primare të cilat publikohen me dinamikë tremujore me të dhënat nga pyetsorët vjetor për investimet në dhe nga jashtë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Pas kryerjes së auditimit, PIN-i negativ neto për vitin 2023 u ul për 188,8 milionë euro dhe është 8.311,3 milionë euro, domethënë treguesi relativ PIN neto, si % e PBB-së është ulur për 1,4 p.p. dhe është 60,9%. Zvogëlimi i PIN-it neto negativ rezulton nga ulja e detyrimeve me 207,6 milionë euro, me rënie të njëkohshme të mjeteve me 18,8 milionë euro.

Në anën e mjeteve, auditim në rënie shënojnë investimet direkte (për 19 milionë euro), gjatë ndryshimeve të vogla të kredive tregtare (për 0,3 milionë euro) dhe huamarrjet (për 0,1 milionë euro), duke rritur kapitalin vetanak të mbetur (për 0,6 milionë euro). Rënia e investimeve direkte rezulton nga ulja e instrumenteve të borxhit (për 14,3 milionë euro) dhe kapitali vetanak¹ (4,7 milionë euro).

Nga ana e detyrimeve, ulja vjen nga investimet direkte (për 210,5 milionë euro), huamarrjet (për 6,9 milionë euro) dhe kreditë tregtare (për 3,1 milionë euro), me rritjen e pjesës tjetër të kapitalit vetanak (për 8,9 milionë euro) dhe investimet e portofolit (për 4 milionë euro). Rënia e investimeve direkte rezulton nga kapitali vetanak (për 114,7 milionë euro) dhe borxhit ndërkompani (për 96,1 milionë euro).

Investimet direkte, neto, janë ulur për 191,5 milionë euro si pasojë e rënies së kapitalit vetanak dhe borxhit ndërkompani.

Rishikimi i të dhënave për 2022 çoi në ulje të neto negative të PIN-it për 18,6 milionë euro dhe është 8.129,2 milionë euro, domethënë treguesi relativ PIN neto si % e PBB-së u ul për 0,1 p.p. dhe është 62,4%. Ulja e PIN-it neto negativ në tërësi rezulton nga rritja e mjeteve për 18,6 milionë euro, si rezultat i mbulimit më të mirë të të dhënave për kapitalin vetanak në kuadër të investimeve direkte.

¹ Përfshirë fitimin e riinvestuar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Efektet nga auditimit mbi PIN-in në vitin 2022 dhe 2023
(në milionë euro, në %)

	2022			2023		
	Para rishikimit	Pas rishikimit	Dallimet	Para rishikimit	Pas rishikimit	Dallimet
PIN-neto	-8,147.8	-8,129.2	18.6	-8,500.1	-8,311.3	188.8
Mjetet	7,648.1	7,666.7	18.6	8,394.6	8,375.8	-18.8
Detyrimet	15,795.9	15,795.9	0.0	16,894.7	16,687.2	-207.6
<i>Sektorët</i>						
PIN,sheti-neto	-3,425.0	-3,425.0	0.0	-3,776.4	-3,775.8	0.6
PIN, banka qendrore neto	3,313.0	3,313.0	0.0	3,929.5	3,929.5	0.0
PIN, institucionet depozitare neto përveç bankës qendrore	-1,330.0	-1,330.0	0.0	-1,326.0	-1,466.5	-140.5
PIN, sektorët e tjerë neto	-6,705.7	-6,687.2	18.6	-7,327.3	-6,998.6	328.7
Mjetet	7,648.1	7,666.7	18.6	8,394.6	8,375.8	-18.8
Investimet direkte	996.2	1,014.8	18.6	1,061.0	1,042.0	-19.0
Investime të portofolit	695.3	695.3	0.0	917.0	917.0	0.0
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opcionet e të punësuarve për blerje të aksioneve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitali i mbetur vetanak	6.0	6.0	0.0	5.2	5.8	0.6
Valuta dhe depozita	653.5	653.5	0.0	650.9	650.9	0.0
Huamarrje	221.6	221.6	0.0	74.9	74.7	-0.1
Sigurime, pensione dhe skema të garancioneve të standartizuara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanse	1,212.4	1,212.4	0.0	1,146.8	1,146.5	-0.3
Llogari të tjera për pagesë	0.3	0.3	0.0	0.6	0.6	0.0
Rezervat devizore	3,862.9	3,862.9	0.0	4,538.4	4,538.4	0.0
Detyrimet	15,795.9	15,795.9	0.0	16,894.7	16,687.2	-207.6
Investimet direkte	7,853.6	7,853.6	0.0	8,492.0	8,281.5	-210.5
Investime të portofolit	2,106.7	2,106.7	0.0	2,319.0	2,323.0	4.0
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opcionet e të punësuarve për blerje të aksioneve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitali i mbetur vetanak	3.3	3.3	0.0	3.2	12.1	8.9
Valuta dhe depozita	471.0	471.0	0.0	462.0	462.0	0.0
Huamarrje	4,043.3	4,043.3	0.0	4,264.2	4,257.3	-6.9
Sigurime, pensione dhe skema të garancioneve të standartizuara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanse	1,062.6	1,062.6	0.0	1,110.2	1,107.1	-3.1
Llogari të tjera për pagesë	5.0	5.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të drejtat special të tërheqjes (Krijimi i detyrimit,neto)	250.5	250.5	0.0	244.2	244.2	0.0
PIN-neto/PBB (%)	-62.5	-62.4	0.1	-62.2	-60.9	1.4

Burimi: BPRMV-ja, EShS-ja.

Informacione shoqëruese

Të dhënat të serive kohore dhe sqarime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/eksterni_statistiki-al.nspix

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspix

Për pyetje nga mediat, ju lutemi kontaktoni personat përgjegjës nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informata më të detajuara lidhur me të dhënat statistikore të publikuara, mund të na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).